



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 24 Prot

Tiranë më 08/01 2015

REKOMANDIM

Nr. 04 ,datë 08/01 2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*".

KONSTATOVA :

Në zbatim të urdhrit nr. 210, datë 25.11.2014 është ushtruar kontroll administrativ pranë kontrolluesit, *Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit*. Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga Zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit me objekt:

*Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.*

Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, është kontrollues publik që zhvillon aktivitetin e tij me qëllim, hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë modernizimin e zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e planifikimit dhe zhvillimit urban, strehimit, legalizimit e integritimit të ndërtimeve informale, turizmit etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rolin e kontrolluesit gjatë ushtrimit të aktivitetit mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale për personat të cilët marrin shërbimet dhe kryejnë procedura pranë këtij kontrolluesi.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi relacionin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi respekton kërkesat ligjore të përcaktuara në nenet 5, 6 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, lidhur me përpunimin në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe të ligjshme, si dhe në zbatimin e kriterëve ligjore gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave personale. Të dhënat personale mblidhen në zbatim të kërkesave ligjore ku bazohet aktiviteti i kontrolluesit.

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna sensitive duke zbatuar kriteret ligjore të nenit 7 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Kontrolluesi kryen transferim ndërkombëtar të të dhënave personale për punonjësit në shtetet me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale dhe në shtete me nivel të pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, për trajnimin dhe shërbimet e tyre

jashtë shtetit për arsye pune, si dhe marrëveshjeve që lidhen me shtete të tjera për aktivitetin që ushtron.

Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet duke respektuar nenet 8, 9 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Kontrolluesi ka krijuar kushte për ushtrimin e të drejtës për akses, ankesa, korrigjime, përditësime etj, për subjektet e të dhënave personale lidhur me të dhënat e tyre personale, në zbatim të neneve 12-17 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Gjithashtu, nga kontrolli administrativ i ushtruar u konstatua se:

Kontrolluesi në faqen e tij zyrtare në internet <http://www.turizmi.gov.al> nuk kishte vendosur rubrikën “politikat e privatësisë” me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe përfshirjen në këtë rubrikë të kushteve, kriterëve që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale, sipas kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar dhe Opinioni të Komisionerit “Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat”.

Kontrolluesi nuk kishte plotësuar “Formularin e Njoftimit” sipas kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Kontrolluesi në Rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit”, nuk kishte përfshirë rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, sipas kërkesave të neneve 27 dhe 28 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Mungesa e rregullave apo hartimi i rregullores së veçantë, në të cilën të jenë shprehur përcaktimet dhe detyrimet që rrjedhin nga nenet 27, 28 të ligjit, të cilat detyrojnë kontrolluesin të marrë masa teknike dhe organizative për përcaktimin e funksioneve ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave, përcaktimin e aksesit, tregon për mungesën e masave të sigurisë dhe shkallën e ulët të konfidencialitetit që ka kontrolluesi në procesin e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Dokumentimi në formë të shkruar i këtyre masave tekniko-organizative dhe zbatimi i tyre në praktikë është garanci për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me ligjin, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së kontrolluesit.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale duhet të kryhet sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Pas kontrollit administrativ të ushtruar kontrolluesi reagoi dhe mori masa për rikuperimin e disa prej shkeljeve të konstatuara, plotësoi në faqen zyrtare të tij në internet rubrikën “Politikat e Privatësisë” lidhur me informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe plotësoi “Formularin e Njoftimit” pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të nenit 21 të ligjit.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 107-109 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";

### REKOMANDOJ :

1. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në portalin zyrtar [www.idp.al](http://www.idp.al), si dhe ofrojmë asistencën tonë.
2. Kryerja e këtij detyrimi të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.
3. Për plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksione për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

**Besnik DERVISHI**  
Komisioneri  
**KOMISIONERI**

